

AKT THEMELIMI

“NIKOPOLIS CLUB EVA” Sh.a

(SISTEMI ME NJE NIVEL)

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa e faqes së internetit

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 01.04.2024, une themeluesi Z.Grigor Tavo , kam krijuar një shoqëri aksionare me emrin **“NIKOPOLIS CLUB EVA” ShA.**

Themeluesi i vetem i shoqërisë **“NIKOPOLIS CLUB EVA”** është z.**Grigor Tavo**, mbajtes i kartes se identitetit me numer NID: **G10327026G**, i datelindjes 27.03.1961, lindur dhe banues ne Jorgucat, Gjirokaster.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Tregti e përgjithshme, import-eksport. Ndertim portesh detare. Agrobiznes, agroperpunim. Punime ndertimi, planifikimi, projektimi perfshire por pa u kufizuar ne ndertime civile dhe industriale, pune publike, qendra biznesi dhe rezidenca, hotele dhe godina akomodimi, rruge, autostrada, ura dhe te gjitha llojet e ndertimeve inxhinierike. Projektim, zbatim, mbikqyrje te punimeve te ndertimit. Konsulence teknike dhe biznesi ne sektorin e ndertimit. Investime te tjera ne sektoroin e pasurive te paluajtshme. Shoqeria mund te veproje si kontraktor i përgjithshem per kryerjen e aktiviteteve te mesiperme dhe bazuar ne diskrecionin e saj te vetem mund te kontraktoje pale te treta per nje pjese apo te gjitha punimet.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë 99 vjet.

Neni 4

Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa Elektronike

Selia e shoqërisë NIKOPOLIS CLUB EVA sha ndodhet ne adresen: Gjirokaster, Dropull i Siperm, Jorgucat, rruga kryesore, pasuria me nr.30/35+30/23, Z.K 2007.

Email: nicopolisclub.info@gmail.com

Kreu II

Kapitali

Neni 5



Kapitali themeltar

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **3600000 Lekë** , i perbere nga **1000 aksione** te zakonshem me vlerë nominale 3600 leke secili. Aksionet e themeluesit në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tij si me poshte:

1. **Aksionari themelues Z.Grigor Tavo** , zoteron 100 % te aksioneve pra 1000 aksione me vlere nominale 3600 leke secili , kontribut ne para.

Neni 6

Këshilli Administrimit

(1) Asambleja e Përgjithshme cakton tre ose më shumë, por jo më shumë se 21, persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën “c”, pika 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat qe burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.

(2) Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.

(3) Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person i cili dëshiron të veprojë në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, duke pasur parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim te numrit të anëtarëve, të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Anëtarit i Këshillit të Administrimit i emëruar në këtë mënyrë do të jetë në detyrë deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.

(4) Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme, sipas shkronjës “c”, pika 2 të nenit 135 të Ligjit.

Natasha Miçi me NID: G85224022T, kryetar me afat 3 vjet

Eftali Gjini me NID: I65410056I, anetar me afat 3 vjet

Redjan Gjini me NID: I60729022D, anetar me afat 3 vjet

Caktohet ekspert kontabel Z.Altin Kosta me NID: I10809172Q me licencen nr.506 date 02/10/2023, me afat 3 vjet

Neni 7

Procesverbali i Mbledhjes së anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të mundësojnë mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve në libra të posaçëm për:

1. të gjithë emërimet e kryera nga anëtarët e Këshillit të Administrimit; dhe
2. të gjithë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve së aksioneve të klasave të ndryshme, dhe mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe komiteteve të Këshillit të

Administrimit, përfshirë edhe emrat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të pranishëm në këto mbledhje.

Neni 8

Administratorët

1. Këshilli i Administrimit zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë trevjeçare, në pajtim me nenin 158 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të Këshillit të Administrimit, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë nga detyra, pa çenuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.
2. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktohen si Administratorë për sa kohë që shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit përbëhet nga persona të pavarur që nuk ushtrojnë kompetenca administrimi.
3. **Caktohet si Administrator i Shoqërisë Z.Grigor Tavo me NID: G10327026G me nje afat 3 vjecar.**
4. Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e pikës 3 dhe 5 të nenit 158 dhe nenin 159 të Ligjit. Detyrat e Këshillit të Administrimit, në përputhje me parashikimet e shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "i" të pikës 1 të nenit 154 nuk mund t'iu delegohen Administratorëve.
5. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit të Administrimit nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 9

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodin Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 10

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Aksionari Themelues i shoqërisë
"NIKOPOLIS CLUB EVA" sh.a**

Grigor TAVO

